

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Ligjet dhe tatimet në Kosovë

P4

ZGJIDHJET

FLETË PROVIMI
(Exam Paper)

Data

14.02.2026

Pjesa A: Pjesa A – 30 Pyetje objektive zgjidhni NJË përgjigje të saktë (1 pikë secila – 30 pikë)

Tatimi në Vlerën e Shtuar (TVSH)

1. E drejta për zbritjen e TVSH-së lind kur:
 - a) Kryhet pagesa
 - b) Dorëzohet deklarata mujore
 - c) Malli/shërbimi pranohet dhe ekziston fatura e rregullt
 - d) Përfundohet viti fiscal

2. Shërbimet e marra nga një jo-rezident dhe të përdorura në Kosovë:
 - a) Nuk tatohen me TVSH
 - b) Tatohen vetëm në vendin e furnizuesit
 - c) Tatohen me mekanizmin e ngarkesës së kundërt
 - d) Tatohen vetëm nëse paguhen me para të gatshme

3. Eksporti i mallrave nga Kosova:
 - a) Përrjashtohet nga TVSH pa të drejtë zbritjeje
 - b) Tatohen me normë standarde
 - c) Tatohen me normë 0% me të drejtë zbritjeje
 - d) Nuk raportohet në deklaratën e TVSH-së

4. Koeficienti i zbritjes së TVSH-së aplikohet kur:
 - a) Subjekti kryen vetëm eksport
 - b) Subjekti ka vetëm furnizime të tatueshme
 - c) Subjekti ka furnizime të përziera
 - d) Subjekti është person fizik

5. Sipas Ligjit për TVSH në Kosovë, vendi i furnizimit të shërbimeve të ofruara nga një person i tatueshëm ndaj një personi tjetër të tatueshëm (B2B) është:
 - a) Vendi ku ndodhet ofruesi i shërbimit
 - b) Vendi ku kryhet fizikisht shërbimi
 - c) Vendi ku është i vendosur pranuesi i shërbimit
 - d) Vendi ku kryhet pagesa

6. TVSH-ja e blerjes së një veture që përdoret pjesërisht për qëllime private:
- a) Zbritet plotësisht
 - b) Nuk zbritet fare
 - c) Zbritet proporcionalisht (max 50%)
 - d) Zbritet vetëm në fund të vitit

Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK)

7. Fitimi tatimor llogaritet duke:
- a) Marrë fitimin bruto
 - b) Zbritur vetëm shpenzimet operative
 - c) Rregulluar fitimin kontabël sipas ligjit tatimor
 - d) Injoruar amortizimin
8. Zhvlerësimi kontabël mbi normat tatimore:
- a) Është i pranueshëm plotësisht
 - b) Krijon humbje tatimore
 - c) Shtohet në fitimin tatimor
 - d) Nuk raportohet
9. Diferenca ndërmjet zhvlerësimit kontabël dhe tatimor është:
- a) Shpenzim i papranueshëm
 - b) Shkelje tatimore
 - c) Diferencë kohore
 - d) Diferencë e përhershme
10. Humbjet tatimore sipas TAK mund të barten:
- a) 3 vite
 - b) 4 vite
 - c) 5 vite
 - d) Pa afat
11. Donacionet janë të zbritshme:
- a) Pa kufizim
 - b) Vetëm për individë
 - c) Deri në kufirin ligjor
 - d) Vetëm nëse miratohen nga ATK

Tatimi në të Ardhurat Personale (TAP)

12. Përfitimet në natyrë për punonjës:

- a) Nuk tatohen nëse janë të organizuara nga biznesi
- b) Tatohen si e ardhur nga paga
- c) Tatohen vetëm me TAK
- d) Janë shpenzim i papranueshëm

13. Tatimi në burim për qiranë e paguar personit fizik rezident është:

- a) 5%
- b) 8%
- c) 9%
- d) 10%

14. Kush ka obligim ligjor për mbajtjen dhe pagesën e TAP-it nga paga?

- a) Punëmarrësi
- b) ATK
- c) Punëdhënësi
- d) Banka

15. Tatimi në burim për shërbime të kryera nga person fizik jo-rezident:

- a) Nuk aplikohet
- b) Aplikohet mbi shumën bruto
- c) Aplikohet vetëm mbi fitimin
- d) Aplikohet në fund të vitit

Ligji i Punës

16. Marrëdhënia e punës krijohet:

- a) Vetëm me kontratë të shkruar
- b) Vetëm pas regjistrimit në ATK
- c) Me fillimin faktik të punës
- d) Me pagesën e pagës së pare

17. Afati maksimal i periudhës së provës është:

- a) 3 muaj
- b) 4 muaj
- c) 6 muaj
- d) 12 muaj

18. Pagesa shtesë për kujdestari është:

- a) +15%
- b) +20%
- c) +30%
- d) +50%

Ligji për Shoqëritë Tregtare

19. Përgjegjësia për pasqyrat financiare bie mbi:

- a) Auditorin
- b) ATK-në
- c) Menaxhmentin e shoqërisë
- d) Bankën

20. SH.P.K. karakterizohet nga:

- a) Përgjegjësi e pakufizuar
- b) Përgjegjësi personale e pronarëve
- c) Përgjegjësi e kufizuar
- d) Status jofitimprurës

21. Dividendi mund të shpërndahet vetëm nëse:

- a) Shoqëria ka qarkullim të lartë
- b) Ka fitim të shpërndarshëm
- c) Ka kredi bankare
- d) Ka miratim nga ATK

Procedurat Tatimore

22. Afati minimal i ruajtjes së regjistrave tatimorë është:

- a) 3 vite
- b) 5 vite
- c) 6 vite
- d) 10 vite

23. Interesi për pagesa të vonuara tatimore llogaritet:

- a) Një herë në vit
- b) Vetëm pas kontrollit
- c) Për çdo muaj apo pjesë të muajit vonesë
- d) Vetëm pas njoftimit

24. Deklarata tatimore konsiderohet e saktë:

- a) Deri në kontrollin e parë
- b) Deri në pagesën e tatimit
- c) Deri në vërtetimin nga ATK
- d) Deri në afatin e ankesës

Kontabilitet & Pensione

25. Parimi i akrealit nënkupton që:

- a) Të ardhurat njihen kur arkëtohen
- b) Shpenzimet njihen kur paguhen
- c) Transaksionet njihen kur ndodhin
- d) Fitimi llogaritet vetëm në fund të vitit

26. Parimi i vazhdimësisë njihet si:

- a) Parimi i akrealit
- b) Materialiteti
- c) Vazhdimësia e veprimtarisë
- d) Konsistenca

27. Qëllimi kryesor i pasqyrave financiare është:

- a) Tatimi korrekt
- b) Raportimi për ATK
- c) Ofrimi i informacionit për vendimmarrje
- d) Llogaritja e dividendit

28. Kontributet pensionale të detyrueshme në Kosovë administrohen nga:

- a) Ministria e Financave
- b) ATK
- c) Banka Qendrore e Kosovës
- d) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës

29. Kontributet pensionale të detyrueshme të punonjësit:

- a) Janë shpenzim i punëdhënësit
- b) Janë tatim i drejtpërdrejtë
- c) Janë pronë individuale e kontribuuesit
- d) Janë të ardhura buxhetore

30. Kontabilisti i certifikuar mban përgjegjësi:

- a) Vetëm morale
- b) Vetëm kontraktuale
- c) Profesionale dhe ligjore
- d) Vetëm ndaj punëdhënësit

Pjesa B – 3 Studime rasti me 5 pyetje objektive secila, (zgjidhni NJË përgjigje të saktë): (30 pikë)

RASTI 1

(10 pikë)

Shoqëria **RetailPlus SH.P.K.** merret me tregti me pakicë të mallrave ushqimore dhe joushqimore. Është e regjistruar për TVSH.

Të dhëna për vitin 2025:

- Shitje mallrash joushqimore (pa TVSH): **420,000 €**
- Blerje vendore mallrash (me TVSH norme standarte): **236,000 €**
- Pagat bruto vjetore: **120,000 €**
- Qira mujore për objekt afarist (pronari – person fizik rezident): **2,000 €**
- Fitimi kontabël para tatimit: **58,000 €**

Pyetje:

1. TVSH e llogaritur nga shitjet është:
a) **75,600 €**
b) 63,000 €
c) 58,000 €
d) 42,000 €

2. TVSH e zbritshme nga blerjet është:
a) **36,000 €**
b) 32,000 €
c) 28,000 €
d) 0 €

3. Tatimi në burim për qiranë vjetore është:
a) **2,160 €**
b) 2,400 €
c) 4,800 €
d) 6,000 €

4. Fitimi tatimor është:

- a) 58,000 €
- b) 60,000 €
- c) 62,800 €
- d) 65,000 €

5. Tatimi në fitim (TAK) është:

- a) 5,800 €
- b) 6,000 €
- c) 6,280 €
- d) 6,500 €

RASTI 2

(10 pikë)

Shoqëria **FreshAgro Processing L.L.C.** merret me:

- blerje të produkteve bujqësore nga fermerë individualë në Kosovë,
- përpunim të produkteve bujqësore,
- shitje të produkteve të freskëta dhe të përpunuara.

Shoqëria është e regjistruar për TVSH dhe mban libra sipas parimit akrual.

Të dhëna për vitin 2025:

1. **Shitje të produkteve bujqësore të freskëta** (pa TVSH – normë e reduktuar):
240,000 €
2. **Shitje të produkteve të përpunuara ushqimore** (pa TVSH – normë standarde):
160,000 €
3. **Blerje të produkteve bujqësore nga fermerë individualë (persona fizikë):**
190,000 €
(fermerët nuk janë të regjistruar për TVSH)
4. **Shpenzime të transportit dhe ambalazhimit** (me TVSH):
47,200 €
5. **Pagesa për punë sezonale** (persona fizikë, pa kontratë afatgjatë):
50,000 € neto (sekondar)
6. **Fitimi kontabël para tatimit:**
72,000 €

Pyetje:

1. TVSH e llogaritur totale nga shitjet është:

- a) 33,600 €
- b) 38,400 €
- c) 43,200 €
- d) 48,000 €**

2. TVSH e zbritshme nga shpenzimet e transportit dhe ambalazhimit është:

- a) 6,400 €
- b) 7,200 €**
- c) 8,000 €
- d) 9,200 €

3. Pagesat për punë sezonale trajtohen:

- a) Si shpenzim i përjashtuar nga TAP
- b) Si pagesa për shërbime, pa obligime tatimore
- c) Si të ardhura personale, subjekt i TAP në burim dhe KP
- d) Si paga, subjekt vetëm i kontributeve pensionale

4. Tatimi në burim (TAP) për punën sezonale me I peraferti është:

- a) 3,600 €
- b) 4,000 €
- c) 5,555 €
- d) 7,200 €

5. Fitimi tatimor dhe tatimi në fitim (TAK) janë më afër:

- a) Fitimi tatimor 67,000 € - TAK 6,700 €
- b) Fitimi tatimor 72,000 € - TAK 7,200 €
- c) Fitimi tatimor 77,000 € - TAK 7,700 €
- d) Fitimi tatimor 82,000 € - TAK 8,200 €

RASTI 3

(10 pikë)

Shoqëria **EduHealth Center** ofron:

- shërbime edukative të licencuara (të përjashtuara nga TVSH),
- shërbime konsulence private (të tatueshme me normë standarde).

Të dhëna për vitin 2025:

- Të ardhura nga edukimi (të përjashtuara): **180,000 €**
- Të ardhura nga konsulenca (pa TVSH): **120,000 €**
- Shpenzime operative (me TVSH): **59,000 €**
- Koeficient i zbritjes së TVSH-së: **40 %**
- Pagat bruto: **90,000 €**

Pyetje:

1. TVSH e llogaritur për konsulencën është:
 - a) 0 €
 - b) 9,600 €
 - c) 21,600 €**
 - d) 36,000 €
2. TVSH totale e shpenzimeve është:
 - a) 9,000 €**
 - b) 10,800 €
 - c) 8,000 €
 - d) 7,200 €
3. TVSH e zbritshme sipas koeficientit është:
 - a) 3,600 €**
 - b) 4,320 €
 - c) 6,000 €
 - d) 10,800 €
4. Për qëllime të TVSH-së, shpenzimet operative të përgjithshme (me TVSH) të EduHealth Center trajtohen:
 - a) Si të lidhura vetëm me furnizimet e tatueshme
 - b) Si të lidhura vetëm me furnizimet e përjashtuara
 - c) Si të lidhura me të gjitha aktivitetet dhe i nënshtrohen koeficientit të zbritjes**
 - d) Si shpenzime jashtë fushës së TVSH-së
5. Pagat e punonjësve të EduHealth Center për qëllime të TVSH-së:
 - a) Ndikojnë në koeficientin e zbritjes
 - b) Zbriten pjesërisht përmes koeficientit
 - c) Janë jashtë fushës së TVSH-së dhe nuk ndikojnë në koeficient**
 - d) Përjashtohen vetëm nëse aktiviteti është i përjashtuar

Pjesa C - Pyetje me përgjigje të zhvilluara (40 pikë)

Problemi 1

(8 pikë)

Kompania "KosTrade SH.P.K." është e regjistruar për TVSH dhe raporton **mujore**. Për muajin **Prill 2025** ka këto transaksione (të gjitha shumat janë **pa TVSH**, përveç kur thuhet ndryshe). Koeficienti i vitit paraprak që përdoret këtë vit është **80%**.

Furnizimet (shitjet)

1. Shitje vendore me normë **18%**: **180,000 €**
2. Shitje vendore me normë **8%**: **40,000 €**
3. Furnizime të përjashtuara **pa të drejtë kreditimi**: **25,000 €**
4. Eksport: **60,000 €**
5. Notë kreditore e lëshuar për klient (18%) : shuma e tatueshme **3,500 €**
6. Borxh i keq i lëshuar (18%) - shuma e tatueshme: **1,000 €**

Blerjet / importet

7. Blerje vendore (18%): **95,000 €**
8. Blerje vendore (8%): **12,000 €**
9. Import mallrash: **CIF 50,000 €**, doganë **5,000 € (18%)**
10. Shërbime konsulence nga jashtë (B2B) - **18,000 €**
11. Notë debitoare e pranuar nga furnitori (8%) - **2,000 €**

Kërkohet:

- a) Llogaritni **TVSH e zbritshme** (me koeficient 80%).
- b) Llogaritni **TVSH e llogaritur**.
- c) Përcaktoni **TVSH për pagesë** ose **tepricë kreditore** për muajin.

Zgjidhje

TVSH NË SHITJE

Furnizime të përjashtuara pa të drejtë kreditimi	25,000.00	
Export	60,000.00	
Shitje 18%	180,000.00	32,400.00
Shitje 8%	40,000.00	3,200.00
Notë debit	1,600.00	128.00
Ngarkesa e kundert (shitje)	18,000.00	3,240.00
Totali TVSH e llogaritur		38,968.00

TVSH NË BLERJE

Blerje me TVSH jo te zbritshme	41,160.00	
Blerje 18%	76,000.00	13,680.00
Blerje 8%	9,600.00	768.00
Import (CIF+Dogane)	44,000.00	7,920.00
Ngarkesa e kundert (blerje)	14,400.00	2,592.00
Notë kredit	3,500.00	630.00
Borxh i keq	1,000.00	180.00
TOTAL TVSH e zbritshme		25,770.00

TVSH për pagesë / kreditim **13,198.00**

Problemi 2

(8 pikë)

Kompania "ProService L.L.C." për vitin 2025 ka:

- Fitimi kontabël para tatimit: **168,400 €**

Detaje shitesë:

1. Zhvlerësimi kontabël: **72,000 €**
2. Zhvlerësimi i lejuar tatimor: **56,000 €**
3. Shpenzime reprezentacioni (50% organizim për prezantimi të kompanisë):
24,000 €
4. Gjoha administrative: **6,500 €**
5. Provizion për llogari të arkëtueshme (kontabël): **18,000**
6. Donacion i dokumentuar për OJQ të regjistruar: **10,000 €**
7. Të ardhura nga dividendi nga shoqëri rezidente: **8,000 €**
8. Shpenzime udhëtimi (të dokumentuara): **14,000 €**
9. Sponsorizim me kontratë në lëmin sportiv - **5,000 €**

Norma e TAK: **10%**

Kërkohet:

- a) Përgatitni **rregullimin tatimor** (shitesa/ zbritje) duke identifikuar shpenzimet e papranueshme dhe trajtimet e veçanta.
- b) Llogaritni **fitimin tatimor**.
- c) Llogaritni obligimin për **TAK** për vitin 2025.

Zgjidhje

Fitimi kontabël **168,400.00**

SHTESA

Diferenca zhvlerësim 16,000.00

Reprezentacion (50%) 12,000.00

Gjoba 6,500.00

Provizion 18,000.00

Donacioni 10,000.00

Sponsorizimi 5,000.00

Totali shtesa 67,500.00

Zbritje (Dividendi) **(8,000.00)**

Fitimi para donacionit 227,900.00

Donacion(max 10%) (10,000.00)

Fitimi tatimor 217,900.00

TAK 10% 21,790.00

Sponsorizimi (max 30%) 5,000.00

TAK për pagesë 16,790.00

Problemi 3**(5 pikë)**

Për muajin **Maj 2025**, kompania **“CallCenter Pro”** ka pagat bruto:

- Punonjësi A: **340 €**
- Punonjësi B: **420 €**
- Punonjësi C: **620 €**
- Punonjësi D: **1,480 €**

Kërkohet (për secilin punonjës):

- a) KP pensional
- b) Baza tatimore pas KP
- c) TAP mujor
- d) Paga neto

Zgjidhje

Punonjësi	Bruto	KP 5%	KP 5%	Baza	TAP	Neto
Punonjësi A	340.00	17.00	17.00	323.00	5.84	317.16
Punonjësi B	420.00	21.00	21.00	399.00	11.92	387.08
Punonjësi C	620.00	31.00	31.00	589.00	29.90	559.10
Punonjësi D	1,480.00	74.00	74.00	1,406.00	111.60	1,294.40
Total	2,860.00	143.00	143.00	2,717.00	159.26	2,557.74

Problemi 4

(4 pikë)

Kompania "FISI SH.P.K." është kontrolluar nga ATK për periudhën 08/2024. Nga kontrolli është konstatuar se kompania ka deklaruar më pak detyrime dhe ATK ka vendosur:

- TVSH shtesë: 3,800 €
 - TAP (tatim në paga) shtesë: 1,200 €
- Totali i tatimit shtesë: 5,000 €

Vendimi i ATK është pranuar më 15.12.2024 dhe kompania e ka paguar tërësisht më 20.03.2025.

Deklarimi nga kompania Fisi SH.P.K 08/2024:

- TVSH : 25,000 €
- TAP (tatim në paga): 15,000 €

Kërkohet:

- Llogaritni **gjobën për nen deklarimin tatimore**
- Llogaritni **interesin** për të njëjtën periudhë deri 20.03.2025.
- Llogaritni **totalin e ndëshkimeve dhe tatimit shtese për pagese me date 20.03.2025**

Zgjidhje

TVSH shtesë	3800
TAP shtesë	1200
Totali shtesë	5000

Gjobë TVSH 25%	950
Gjobë TAP 15%	180
Totali gjoba	1130

Interesi (0.65% x 7 muaj)	227.5
Totali për pagesë	6357.5

Problemi 5

(15 pikë)

Shoqëria ndërtimore “URBAN DEVELOPMENT SH.A.” ka filluar një projekt ndërtimi që zgjat **dy (2) vite**, me qëllim shitjen e njësisve banesore dhe lokaleve afariste.

Të dhëna bazë të projektit

- Sipërfaqja totale për shitje: **3,000 m²**
- Kosto e ndërtimit për m² (e përllogaritur paraprakisht dhe e pandryshuar): **750 €/m²**
- Kosto totale e projektit:
3,000 m² × 750 € = 2,250,000 €

Struktura e projektit

- **30% e sipërfaqes janë lokale afariste**
- **70% e sipërfaqes janë njësi banesore**

Kategoria	%	m ²
Banesa	70%	2,100 m ²
Lokale afariste	30%	900 m ²
Totali	100%	3,000 m²

Kontrata e kompensimit me pronarët e tokës

- Pronarët e tokës kompensohen me **31% të metrazhit total për shitje**
- Kompensimi realizohet **në natyrë (njësi të ndërtuara)**

Viti i parë i projektit (Viti 1)

a. Shitjet e realizuara

- Banesa të shitura: **300 m²**
- Lokale afariste të shitura: **200 m²**
- Faturimi I plote I pronareve për kompensim

b. Çmimet e shitjes (pa TVSH)

- Banesa: **1,200 €/m²**
- Lokale afariste: **2,000 €/m²**

c. Inkasimi dhe njohja e të ardhurave

- Në vitin e parë është realizuar **inkasim kesh në masën 20%** të vlerës totale të shitjeve
- Sipas rregullave të kontratave afatgjata:

d. TVSH në blerje (Viti 1)

- TVSH në blerje gjatë vitit të parë: **100,000 €**

Viti i dytë i projektit (Viti 2)

- Nuk ka **shitje të reja**
- Projekti **përfundon plotësisht**
- TVSH në blerje gjatë vitit të dytë: **300,000 €**

Rregulla shtesë për TVSH

- Për TVSH në blerje, zbatohet **koeficienti i zbritjes**, i llogaritur në bazë të koeficientit
- TVSH për lokalet e kompensimit për pronarët e tokës **duhet të llogaritet dhe deklarohet** sipas çmimeve të shitjes.

KËRKOHET

a. Të llogaritet **Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK)** për:

- **Vitin e parë,**

b. Të llogaritet **Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK)** për:

- **Vitin e dytë,**

c. Të përcaktohet **vlera e stokut në fund të vitit të dytë**, pas përfundimit të projektit.

d. Të llogaritet **detyrimi i TVSH-së** për:

- **Vitin e parë**
- **Vitin e dytë**

Zgjidhje

Të dhënat		
Sipërfaqe totale për shitje (m ²)	3000	
Kosto për m ² (€)	750.00	
Banesa (% / m ²)	70.00%	2,100
Lokale afariste (% / m ²)	30.00%	900
Çmimi shitjes banesa (€/m ²)	1,200.00	
Çmimi shitjes lokale (€/m ²)	2,000.00	
TVSH për lokale	18.00%	
Kompensim pronarë (% e m ²)	31.00%	
Shitje V1 - banesa (m ²)	300	
Shitje V1 - lokale (m ²)	200	
Inkasim kesh V1 (% e shitjeve te klientët)	20.00%	
TVSH në blerje V1 (€)	100,000.00	
TVSH në blerje V2 (€)	300,000.00	
Norma TAK	10.00%	
Koeficienti TVSH (bazuar në 30% lokale)	30.00%	

A) TAK - NJOHJA E TË ARDHURAVE, KMSH DHE DETYRIMI	
VITI I	
1. Të ardhurat V1 = kesh + kompensim	
Shitje V1 - banesa (€) = 300 m ² × 1,200	360,000.00
Shitje V1 - lokale (€) = 200 m ² × 2,000	400,000.00
Totali shitje V1 (pa TVSH)	760,000.00
Të ardhura V1 nga kesh (20% e shitjeve te klientët)	152,000.00
Kompensim total (m ²) = 31% × 3,000	930
Kompensim banesa (m ²) = 70% × kompensim	651
Kompensim lokale (m ²) = 30% × kompensim	279
Vlera kompensim banesa (€) = m² × 1,200	781,200.00
Vlera kompensim lokale (€) = m² × 2,000	558,000.00
Totali kompensim (pa TVSH)	1,339,200.00
Të ardhura totale V1 (kesh + kompensim)	1,491,200.00

2. KMSH V1 me koeficient të ardhurash	
Koeficient V1 = Të ardhura V1 / Të ardhura totale plan	0.7103
KMSH V1 = Kosto per m ²	750.00
m ² të dala (shitje + kompensim)	1,430
KMSH totale (m² të dala) = m² × 750	761,796.75

3. TAK (10%)	
Fitimi V1 = Të ardhura V1 – KMSH V1	729,403.25
TAK V1 = Fitimi V1 × 10%	72,940.33
VITI II	
1. Të ardhurat V2 = pjesa e mbetur (akrual)	
Të ardhura V2 (pjesa e mbetur 80% e shitjeve V1)	608,000.00
	0.29
2. KMSH V2 = KMSH totale – KMSH V1	
m ² stok fund V2 = 3,000 – m ² të shitura	1,570
Stoku fund V2 (kosto) = m ² stok × 750	1,177,500.00

3. TAK (10%)	
Fitimi V1 = Të ardhura V2 – KMSH V2	297,296.75
TAK V2 = Fitimi V2 × 10%	29,729.68

B) TVSH - Shitje vetëm për lokale; Blerjet me koeficient 30%	
VITI I	
TVSH ne shitje	
V1: Bazë lokale e faturuar (20% e lokaleve të shitura)	400,000.00
V1: TVSH për lokalet e shitura (18%)	72,000.00
V1: Bazë lokale kompensim	558,000.00
V1: TVSH për lokalet e kompensimit (18%)	100,440.00
V1: Totali TVSH e llogaritur	172,440.00
TVSH ne blerje (me koeficient 30%)	
V1: TVSh ne blerje	100,000.00
V1: TVSH e zbritshme × 30%	30,000.00
TVSH e paguar	142,440.00
VITI II	
TVSH ne blerje (me koeficient 30%)	
V2: TVSh ne blerje	300,000.00
V2: TVSH e zbritshme × 30%	90,000.00
TVSH e paguar/kreditim	-90,000.00